- 2.3.3** *Operatori ekonomik ofertues duhet të ketë 1 (nje) mjek ndërmarrjeje te punesuar me kohe te plote, gjate periudhes 6 muajt e fundit nga data e zhvillimit te tenderit, në bazë të paragrafit 12/2 të VKM Nr. 692, datë 13.12.2001 “Për masat e vecanta të sigurimit dhe mbrojtjes së shëndetit në punë”, i ndryshuar.*

Kjo të vërtetohet me paraqitjen e një CV-je, Licensës, Diplomës, Kontratës së Punës, Certifikatave të trajnimeve dhe listpagesat E-Sig ku personi i mesiperm te jetë i pasqyruar në listëpagesa të paktën për periudhën e kërkuar.

- 2.3.4** *Operatori Ekonomik ofertues duhet te kete ne stafin e tij te pakten 1 (nje) Ekspert Mjedisi te pajisur me Certifikate per Vleresimin e Ndikimit ne Mjedisi dhe Auditimin Mjedisor nga Ministri, ne zbatim te ligjit Nr. 10081, datë 23.2.2009 “Për Licencat, autorizimet dhe lejet në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.*

Lidhur me kete pike operatori ekonomik ofertues duhet te paraqese: i) kontratat individuale te punes ii) Certifikatat perkatese si dhe iii) listpagesat E-Sig ku personat e mesiperm te jene te pasqyruara ne listepagesa te pakten per periudhen e 6 muajve te fundit nga data e zhvillimit te tenderit.

- 2.3.5** *Operatori ekonomik ofertues qe do te realizoje kete kontrate, duhet te jete i pajisur dhe te paraqese certifikatat perkatese te vlefshme te ISO-ve ose ekuivalent (të përkthyer dhe të noterizuara), te leshuara nga organizmat e vleresimit te konformitetit, te akredituara nga DPA, ose organizma nderkombetare akreditues te njohur nga Republika e Shqiperise, si me poshte:*

- ISO 18001: për Sistemin e menaxhimit të shëndetit dhe sigurisë në punë, në qëllimin e të cilit të jetë parashikuar “Pastrimi i ndërtesave civile dhe industriale...”
- ISO 14001: për sistemin e menaxhimit të cilësisë së mjedisit, në qëllimin e të cilit të jetë parashikuar “Pastrimi i ndërtesave civile dhe industriale....”
- ISO 9001: për Sistemin e menaxhimit të cilësisë, në qëllimin e të cilit të jetë parashikuar “Pastrimi i ndërtesave civile dhe industriale....”

2.3.6 *Operatori Ekonomik ofertues duhet të disponojë licencat e mëposhtme:*

- *Licencën për Veprimtarinë e ekspertizës lidhur me ndikimin në mjedis me Kod III.2.A, për shkak se këto veprimtari kanë ndikim në mjedis, dhe OE duhet të vërtetojë se disponon kapacitetin dhe eksperiencën e duhur për të kryer shërbimin.*
- *Licencën për Sherbime ekspertize dhe/ose profesionale të mbrojtjes civile, me kod I.2.A ose të kete nje kontrate me nje shoqeri qe e disponon kete Licence. Lidhur me kete pike O.E ofertues duhet te paraqese Licencen me kod I.2.A te tijen dhe ne rastin tjeter duhet te paraqese licencen e shoqerise qe ka kontraktuar si dhe kontraten qe ka nenshkruar me te per kete qellim.*

2.3.7 *Operatori Ekonomik duhet të caktojë nëpërmjet një Deklarate nga Administratori i shoqërisë Supervisorin për ndjekien e Kontratës, i cili duhet të ketë eksperiencë në fushën e shërbimeve sipas objektit të këtij prokurimi, për të cilin duhet të paraqitet Kontrata e Punës, Diploma, Certifikata e vlersimit të ndikimit në mjedis dhe CV-ja.*

2.3.8 *Detergjentët e kerkuar për kryerjen e shërbimit të pastrimit duhet të jenë të një cilësie të lartë, kjo për shkak të vetë cilësisë së lartë të ambienteve të brendshme të OST Sh.a. Ato duhet të jene ne perputhje me specifikime teknike te kerkuara ne DT.*

- *Lidhur me kete pike operatori ekonomik ofertues duhet te paraqese specifikimet teknike të perkthyer dhe të noterizuara te tyre.*
- *Detergjentët duhet të jenë të një marke të njohur, dhe kjo duhet të vërtetohet me paraqitjen e faturave Pro Forma të blerjes së këtyre detergjentëve nga firmat prodhuese.*

2.3.9 *Operatori ekonomik ofertues duhet të kete nje ekspert zjarrfikes vertetuar me kontrate pune, certifikata perkatese, CV, per periudhen gjate periudhes 6 muajt e fundit nga data e zhvillimit te tenderit.*

2.3.10 *Operatori ekonomik ofertues, ditën dhe orën e caktuar për hapjen e ofertave duhet të paraqese pranë Autoritetit kontraktor nga një moster për artikujt që do të përdoren gjatë kryerjes së shërbimit, sipas tabelës që vijon:*

1	2	3
Nr.	PËRSHKRIMI	Sasia
AKSESOR PASTRIMI KONSUMI		
1	Letra duarsh	pako 1
2	Letra kuzhine	rulona 1
3	Letra higjenike	“ 1
4	Leckë pllakash	copë 1
5	Lecka mikrofibra	“ 1
6	Dizinfektant banjoje	“ 1
7	Fshesa për fshirje ne te thate	“ 1
8	Garzat e trajtuara	“ 1

9	Leckat Mop	“	1
10	Detergjent dyshemeje	lit	1
11	Dizinfektant dyshemeje	“	1
12	Sapun likuid	bidona	1
13	Aromë ambienti	copë	1
14	Detergjent xhamash	“	1
15	Qese mbeturinash (100)	pako	1
16	Qese mbeturinash (70)	“	1
17	Qese mbeturinash (50)	“	1
18	Detergjent per lucidimin e pjeseve te krumuara	“	1
19	Solucion per shkelqim mobiljesh	“	1
20	Solucion per pastrim dyshemeje industriale	lit	1
21	Solucion per dyshemene e trajtuar/lyer, resina	“	1
22	Solucion per pastrim inkasosh dhe ashensoresh	cope	1
23	Dizinfektant antikalkare	“	1
24	Solucion per pastrim kompjuterash	“	1
25	Solucion per pastrim mermeri	lit	1

2.3.11 *Operatori ekonomik ofertues duhet të ketë në pronësi, me qira ose huapërdorje makineritë profesionale për ofrimin e shërbimit të dezinfektimit si mëposhtë:*

- *Të paktën 2 pompa motorrike të montueshme në automjet;*
- *Pompë dezinfektimi për ambjentet e jashtme të paktën 1 cope;*
- *Pompë dezinfektimi për ambjentet e brendshme të paktën 1 copë.*

Lidhur me këtë pikë, OE duhet të paraqesë (për secilën nga makineritë/pajisjet) certifikatën e pronësisë/kontratën e qirasë/kontratën e huapërdorjes/dokumentin e zhdoganimit/faturë tatimore dhe foto. Për rastet kur parashikohet edhe leje qarkullimi, siguracion, kolaudim.

2.3.12 *Operatori Ekonomik ofertues duhet te kete ne pronesi ose me qera, automjetet dhe makinerite, sipas Termave te References, te nevojshme per kryerjen e sherbimit te kerkuar:*

- *Makina fshirëse e trotuareve 1*
- *Makina larëse e dyshemesë – lavasciuga 1*
- *Makina kositëse e barit 2*
- *Makinë teknologjike për heqjen e mbeturinave 1*
- *Autokullë vinç 1*
- *Platformë ajrore / ngritëse 1*
- *Autobot per furnizimin e ujit 1*
- *Autobot Pompe per heqjen e ujrave te zeza 1*
- *Makineri thithëse pluhurash dhe lëngjesh 6*
- *Makineri larje-tharje 1*
- *Pompa ULV 5*
- *Pompë motorike të montueshme në automjet për kryerjen e DDD-ve 1*
- *Mjete transporti për njerëzit dhe mallrat 1*

Lidhur me këtë pikë, OE duhet të paraqesë (për secilën nga makineritë/pajisjet) certifikatën e pronësisë ose kontratën e qirasë/dokumentin e zhdoganimit/faturë tatimore dhe foto. Për rastet kur parashikohet edhe leje qarkullimi, siguracion, kolaudim.

2.3.13 *Ne funksion te plotesimit te Shtojces 7 “Deklaratë mbi përmbushjen e kriterëve të përgjithshme” Operatori Ekonomik ofertues duhet të japë me një vetëdeklarim, të dhëna të qarta si: Emër, Mbiemër, Atësi, Amësi, Datëlindje, Vendlindje, Numer Personal (i cili është i shënuar në dokumentin e identifikimit), shoqëruar dhe kopje të skanuar të dokumentit të identifikimit (shqiptar ose të huaj), për Administratorin/Administratorët e shoqërisë, Ortakun/Ortakët e shoqërisë, përfaqësues të ndryshem të posaçëm të shoqërisë, drejtues të ndryshem të shoqërisë (përfshirë të gjithë drejtuesit teknike që janë të pasqyruar në licencën e shoqërisë).*

Në rastin e Bashkimit të Operatorëve Ekonomikë, secili nga anëtarët e bashkimit, duhet të plotësojë këtë vetëdeklarim.

Të gjithë dokumentat duhet të jenë origjinalë ose kopje të noterizuara të tyre. Rastet e mosdorëzimit të një dokumenti, ose të dokumentave të rreme e të pasakta, konsiderohen si kushte për skualifikim.

Shenim: Ne respektim te nenit 23 te LPP- se, ne te gjitha rastet ne dokumentet e tenderit kur permendet “marke” perfshihet termi “ekuivalente”

Shtojca 9

[*Shtojcë për t’u plotesuar nga Autoriteti Kontraktor*]

SPECIFIKIMET TEKNIKE

Sipas **Shtojces 12** te DST-ve

Shtojca 10

[Shtojcë për t’u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor në marrëveshjen kuadër]

PLANIFIKIMI I KONTRATAVE NË MARRËVESHJEN KUADËR

<input type="checkbox"/> Shërbim: Numri total i kontratave sipas Marrëveshjes Kuadër _____		
Kontrata Nr.	Titulli i Kontratës	Përshkrim i shkurtër i kontratës
01	_____	_____
02	_____	_____
03	_____	_____
...	_____	_____

Shtojca 11

SHËRBIMET DHE GRAFIKU I EKZEKUTIMIT

Shërbimi që kërkohet: “Shërbimi i pastrimit dhe gjelberimit për godinen qendrore të OST sh.a”

Afatet e ekzekutimit: 12 (dymbëdhjete) muaj nga nënshkrimi i kontratës.

Shtojca 12

TERMAT E REFERENCËS

I. OBJEKTIVI I SHËRBIMIT PËR AMBIENTET E ADMINISTRATËS QENDRORE:

Ofrimi i shërbimit të mirëmbajtjes së përditshme të ambienteve të brendshme, të jashtme dhe të gjelbërta të godinës së OST që ndodhet në Kashar, Tiranë.

Shërbimi i mirëmbajtjes dhe pastrimit të ambienteve të brendshme, të jashtme dhe të gjelbëruara duhet të ofrohet duke vënë në dispozicion fuqinë punëtore, mjetet dhe materialet profesionale të pastrimit të Kontraktuesit sipas kërkesave në vijim:

Sipërfaqet e ambienteve të brendshme, të jashtme dhe të gjelbra të godinës tre katëshe janë si më poshtë:

1. Sipërfaqe pllakash në ambiente të brendshme 1703 m².
2. Sipërfaqe parketi 370 m².
3. Sipërfaqe e dyshemesë teknike 2515 m².
4. Sipërfaqe bodrumi me kuarc 1470 m².
5. Sipërfaqe xhamash 1120 m².
6. Sipërfaqe oborri me asfalt 1240 m².
7. Sipërfaqe oborri me pllaka betoni 3105 m².
8. Sipërfaqe e parkimit brenda oborrit 850 m².
9. Sipërfaqe e parkimit jashtë ndërtesës 370 m².
10. Sipërfaqe pllakash në ambientet jashtë ndërtesës 240 m².
11. Sipërfaqe ballkoni 248 m².
12. Sipërfaqe gjelbërimi 8200 m².
13. Parmak metalike të brendshme 90 ml.
14. Sipërfaqe e ambientit që shërben për bar- kafe 154.8 m².
15. Sipërfaqe e lulishtes së brendshme 66 m².
16. Sipërfaqe e Receptonit të hyrja e objektit 135 m².
17. Sipërfaqe pandusi me beton 1060 m².
18. Sipërfaqe dhomave teknike 220 m².
19. Sipërfaqe e interkapetit me beton 525 m².
20. Sipërfaqe e Sallës së Konferencës dhe Sallave të Mbledhjeve 213 m².
21. Sipërfaqe e Magazinave dhe Arkivave 832 m².
22. Dyer 2 kanatëshe 22 copë dhe dyer 1 kanat 144 dhe emergjence 7 copë.
23. Sipërfaqe e ambienteve që shërbejnë për Panelet Elektrik, Interkapetit, Bateri, Depo e Ujit, Dhomat e Serverave, Dhomat e Teknologjike 887 m².

24. Sipërfaqe e Dispeçerisë 200 m².

Grafiku i Shërbimeve të pastrimit të ambienteve të brendshme:

Shërbime me frekuencë ditore.

- Pastrimi, larja e dyshemesë së korridoreve dhe open space.
- Mbledhje dhe zëvendësim me qese i koshave (për tualet, zyra dhe korridore).
- Pastrimi i tavolinave, karrigeve dhe pajisjeve informatike mbi to.
- Pastrimi i dollapëve, rafteve dhe mobilieve të tjera.
- Pastrimi i moketeve, tapeteve (Dispeçeria).
- Pastrimi i dyshemeve, industriale, mermeri, me pllaka, parketi dhe kuarc të të gjitha ambienteve.
- Pastrimi i WC-ve, aksesoreve, dyshemeve, pllakave dhe mureve të tualetit dhe dezinfektimi i tyre brenda dhe jashtë.
- Kontrolli dhe zëvendësimi i materialeve të konsumit në WC (letër higjienike, letër dhe likuid duarsh).
- Pastrimi i merimangave nga brenda dhe jashtë.
- Pastrimi i ashensorëve.
- Pastrimi i dyerve hyrëse, dyert e emergjencave dhe dyert e ambienteve të brendshme (zyra, magazina, arkiva, salla mbledhjeve etj.).
- Pastrimi i parrakëve metalik të brendshëm.
- Pastrimi i zyrave, dyshemesë dhe mobileve brenda tyre.
- Pastrimi i laboratorëve dhe ambienteve të shërbimit.
- Pastrimi i dyshemesë me pllaka përpara derës hyrëse (në ambientit e brendshëm dhe të jashtëm) dhe në ambientin mbrapa godinës.

Shërbime me frekuencë periodike.

- Pastrimi i Sallës së Konferencave dhe dy Sallave të Mbledhjeve (një herë në javë).
- Pastrimi i ballkoneve, dyshemenë dhe parrakët (një herë në javë).
- Pastrimi i Magazinave dhe Arkivave (një herë në javë).
- Korrja e barit (dy herë në muaj).
- Pastrimi i Oborrit, pllakat e betonit, pllakat e parkimit jashtë dhe brenda, asfaltin etj. (një herë në muaj).
- Pastrimi i xhamave brenda dhe jashtë (një herë në muaj).
- Pastrimi i ambienteve që shërbejnë për Panelet Elektrik, Interkapetit, Bateri, Depo e Ujit, Dhomat e Serverave, Dhomat e Teknologjike, pastrim dyshemeje dhe merimangat (një herë në muaj).

- Vaditja, prashitja e luleve në vazo brenda dhe jashtë ndërtesës, e luleve rreth perimetrit të ndërtesës dhe e pemëve (dy herë në javë, sipas nevojës).
 - Kontroll dhe heqja e mbeturinave nga gropa septike (një herë në muaj sipas nevojës).
 - Kontroll dhe riparim i hedhësve të ujit (sprucatorëve) për vaditje (një herë në muaj sipas nevojës)
 - Furnizimi me ujë i depove për vaditje 1200 m³ në total (çdo ditë, muajt e verës, sipas nevojës)
 - Krasitja e pemëve dhe e shkurreve (dy herë në vit, sipas nevojës).
 - Shërbim me Dezinfektim, dezinfektim, deratizim (një herë në muaj sipas grafikut)
 - Mbjellje, zëvendësim i luleve për ambientet e jashtme, mëllaga, ciklamin, etj. (dy herë në vit).
- ★ *Dispeçeria ku përfshihet Salla e komandës (Dispeçeria), Kuzhina dhe Tualeti me sipërfaqe 200 m² për shkak të profilit të punës 24 orë çdo ditë të javës, do të kenë një frekuencë pastrimi nga e Hëna në të Diel.*
- ★ *Sipërfaqja e ambientit që shërben për Bar – Kafe, pastrohet nga vetë Operatori Ekonomik që e ka marr këtë ambient me qira.*

Tabelë përmbledhëse – Grafiku i kryerjes së shërbimit të pastrimit të ambienteve të brendshme.

Nr.	Lloji i Shërbimit	Frekuenca e pastrimit
1	Pastrimi, larja e dyshemesë së korridoreve dhe open space.	Çdo ditë
2	Mbledhje dhe zëvendësim me qese i koshave (për tualet, zyra dhe korridore).	Çdo ditë
3	Pastrimi i tavolinave, karrigeve dhe pajisjeve informatike mbi to.	Çdo ditë
4	Pastrimi i dollapëve, rafteve dhe mobilieve të tjera.	Çdo ditë
5	Pastrimi i moketeve, tapeteve (Dispeçeria).	Çdo ditë nga e Hëna në të Diel
6	Pastrimi i dyshemeve, industriale, mermeri, me pllaka, parketi dhe kuarc të të gjitha ambienteve.	Çdo ditë
7	Pastrimi i WC-ve, aksesorëve, dyshemeve, pllakave dhe mureve të tualetit dhe dezinfektimi i tyre brenda dhe jashtë.	Çdo ditë
8	Kontrolli dhe zëvendësimi i materialeve të konsumit në WC (letër higjienike, letër dhe likuid duarsh).	Çdo ditë
9	Pastrimi i merimangave nga brenda dhe jashtë.	Çdo ditë
10	Pastrimi i ashensorëve.	Çdo ditë
11	Pastrimi i dyerve hyrëse, dyert e emergjencave dhe dyert e ambienteve të brendshme (zyra, magazina, arkiva, salla mbledhjeve etj.).	Çdo ditë
12	Pastrimi i parmakëve metalik të brendshëm.	Çdo ditë
13	Pastrimi i zyrave, dyshemesë dhe mobileve brenda tyre.	Çdo ditë

14	Pastrimi i laboratorëve dhe ambienteve të shërbimit.	Çdo ditë
15	Pastrimi i dyshemesë me pllaka përpara derës hyrëse (në ambientit e brendshëm dhe të jashtëm) dhe në ambientin mbrapa godinës.	Çdo ditë
16	Pastrimi i Sallës së Konferencave dhe dy Sallave të Mbledhjeve.	Një herë në javë
17	Pastrimi i ballkoneve, dyshemenë dhe parmacët.	Një herë në javë
18	Pastrimi i Magazinave dhe Arkivave.	Një herë në javë
19	Korrja e barit.	Dy herë në muaj
20	Pastrimi i Oborrit, pllakat e betonit, pllakat e parkimit jashtë dhe brenda, asfaltin etj.	Një herë në muaj
21	Pastrimi i xhamave brenda dhe jashtë.	Një herë në muaj
22	Pastrimi i ambienteve që shërbejnë për Panelet Elektrik, Interkapetit, Bateri, Depo e Ujit, Dhomat e Serverave, Dhomat e Teknologjike, pastrim dysHEMEJE dhe merimangat.	Një herë në muaj
23	Vaditja, prashitja e luleve në vazo brenda dhe jashtë ndërtesës, e luleve rreth perimetrit të ndërtesës dhe e pemëve.	Dy herë në javë
24	Krasitja e pemëve dhe e shkurreve.	Dy herë në Vit
25	Kontroll dhe heqja e mbeturinave nga gropa septike.	Një herë në muaj
26	Kontroll dhe riparim i hedhësve të ujit për vaditje (sprucatorëve).	Një herë në muaj
27	Furnizimi me ujë i depove për vaditje 1200 m ³ në total.	Çdo ditë (në verë)
28	Mbjellje, zëvendësim i luleve për ambientet e jashtme, mëllaga, ciklamin, etj. (dy herë në vit).	Dy herë në Vit
29	Shërbim me Dezinfektim, dezinfektim, deratizim.	Një herë në muaj

**Përveç Shërbimeve sipas grafikut të mësipërm do të kryhen shërbime pastrimi të tjera, në kushte të jashtëzakonshme në funksion të mirëmbajtjes ditore të ambienteve të brendshme.*

Punonjësit e Shërbimit:

Kontraktuesi për kryerjen e Shërbimit duhet të ketë 12 punonjës në total. Për kryerjen e shërbimit të pastrimit të ambienteve të brendshme, duhet të vihen në dispozicion 10 (dhjetë) punonjës pastrimi 4 (katër) punonjës për turnin e parë dhe 6 (gjashtë) punonjës për turnin e dytë. Për mirëmbajtjen e ambienteve të gjelbra të OST, Kontraktuesi duhet të vejë në dispozicion 2 (dy) kopshtarë. Krahas punonjësve të pastrimit, Kontraktuesi duhet të sigurojë edhe 1 (një) Supervisor me kohë të plotë, i cili duhet të mbikëqyrë punën e të gjithë punonjësve, të jetë pikë kontakti midis Kontraktuesit dhe Autoritetit Kontraktor dhe të jetë në dispozicion të Autoritetit Kontraktor për çdo kërkesë apo problematikë që mund të lindë. Punonjësit e pastrimit, gjatë kohës së punës duhet të jenë të veshura me uniformën e Kontraktuesit, e cila duhet të jetë gjatë gjithë kohës e pastër dhe e rregullt.

Oraret e kryerjes së shërbimit:

Shërbimi i pastrimit të ambienteve të brendshme do të kryhet nga dita e Hënë në të Premte, në 2 turne, me oraret si më poshtë:

- a- Turni I: 06:30 – 14:30
- b- Turni II: 14:30 – 20:30

Punonjëset e të dyja turneve, duhet të fokusohen në pastërtinë e korridoreve dhe ambienteve të përbashkëta dhe tualeteve (pastrimi i dyshemesë, zëvendësimi i qeseve të koshave të mbeturinave, letrave të duarve, letrave higjienike) etj.

Punonjëset e turnit të parë duhet të përqendrohen në mirëmbajtjen e ambienteve të përbashkëta, korridoreve, tualeteve, ashensorëve, pastrimin e hyrjeve, laboratorëve, Magazinave, Arkivat, Sallat e Mbledhjeve dhe të Konferencave etj. Kontrollimi i pastërtisë së tualeteve duhet të bëhet periodikisht (të paktën çdo 60 minuta). Punonjëset e turnit të dytë duhet të bëjnë pastrime me themel duke filluar me pastrimin e tualeteve dhe më pas me larjen e dyshemesë së korridoreve me makineri lavasciuga, pastrimin e ashensorëve, pastrimin e tavolinave të punës dhe pajisjeve informatike mbi to, karrigeve, zyrave dhe mobilieve brenda tyre, dollapëve, rafteve dhe mobileje e tjera, pastrimin e moketeve dhe tapeteve, pastrimin e dyerve etj.

Materialet e pastrimit:

Për kryerjen e shërbimit të pastrimit të ambienteve të brendshme të godinës 3 – katëshe të OST, nga Kontraktori duhet të vihen në dispozicion materiale shumë cilësore, për shkak të vetë cilësisë së lartë të strukturës së brendshme. Ato nuk duhet të jenë gërryes dhe duhet të jenë në të njëjtën kohë pastrues dhe higjienizues. Kontraktori duhet të vejë në dispozicion (por pa u kufizuar në to) materiale të tilla si: kosha të vegjël për zyra, korridore tualete, qese mbeturinash, detergjent për pastrim dyshemeje (i cili duhet të jetë sipas llojit përkatës të dyshemesë), detergjent për pastrim moketi, materialet e konsumit (letër higjienike, letër duarsh, sapun likuid), lecka mikrofibër për marrjen e pluhurave, shtupa të posacme për tualete, lecka për fshirje në të thatë, solucion për pastrim pajisjesh informatike, solucion për pastrim ashensorësh, set për larjen e xhamave, karela pastrimi (të paktën nga 1 për çdo kat, pasi duhet të shmangen kohët e “lëvizjeve të vdekura” gjatë së cilës punonjëset do të lëvizin për marrjen e materialeve dhe detergjenteve që i duhen për pastrim), fshesa korenti etj.

Detergjentet që duhet të vihen në dispozicion duhet të jenë të një cilësie të lartë, dhe duhet të kenë këto specifikime teknike:

- Tretësit e përshtatshëm: Sprucim me ujë, shkumë, pluhur, CO₂.
- Nuk duhet të jetë i ndezshëm.
- Të mbahen në enë të mbyllura, të cilët të jenë të etiketuara.
- Vlera e pH në 20^o Celsius – nga 7,00 në 30,00 g/l.
- Tretshmëria në ujë: e pakufizuar.
- Densiteti në 20^o Celsius – 1,0290 gr/cm³.
- Viskoziteti në 20^o Celsius – 210 mPas.
- Të jetë e biodegradueshme.

- Shkalla e eliminimit: >90%.

Në rast se materialet e pastrimit nuk janë të një cilësie të lartë, nuk do të pranohen nga AK.

Furnizimi me materiale pastrimi duhet të bëhet sipas një itinerari të caktuar apo sipas nevojave dhe konsumimit, nën kujdesin e Supervizorit të Kontraktuesit i cili duhet të bëjë shpërndarjen e tyre dhe të sigurojë që mos të mungojë asnjëherë furnizimi.

Tualetet e brendshme të godinës tre katëshe dhe të ambienteve të jashtme të saj janë si më poshtë:

- Para tualetet 14 copë.
- Tualetet 32 copë.
- Numri i punonjësve (stafi i OST sh.a.), që do të ofrohet shërbimi është 245 persona.

Kontraktuesi duhet të bëjë furnizimin me materiale e detergjente pastrimi dhe mirëmbajtje duke pasur parasysh ambientet e mësipërme.

Pastrimi i dyshemesë: Duke qenë se dyshemeja është me përbërje të ndryshme, edhe mënyra e pastrimit të saj duhet të bëhet në varësi të llojit të dyshemesë. Më poshtë po paraqesim një përshkrim mbi mënyrën e pastrimit dhe mjetet që duhet të përdoren përkatësisht:

Sipërfaqet e mermerit:

Mermeri është një gur shumë delikat, i cili duhet të trajtohet me kujdes. Për pastrimin e një sipërfaqeje mermeri në mënyrë natyrale duhet të përgatitet një kovë me ujë të ngrohtë dhe të paktën 3 lecka microfibrë ose lecka të tjera të buta dhe thithëse, të lehta për tu shtrydhur. Fillimisht kalohet mbi mermer një copë e thatë për heqjen dhe thithjen e pluhurit. Nëse nuk ka njolla, mjafton një pastrim me leckë microfibrë e lagur me ujë të ngrohtë, e cila heq shenjat e papastërtive. Në rast se ka njolla, duhet të përdoret një sfungjër i butë pasi t'i jenë hedhur disa pika sapuni ekologjik ose me një sapun natyral (nuk duhet të përdoret kurrë product me pH acidic).

Nëse derdhet ushqim apo pije, për të shmangur prishjen apo errësimin duhet të bëhet menjëherë pastrim. Pastrohet sipërfaqja me ujë me sapun likuid ekologjik – detergjent i butë. Shpëlahet me ujë të ngrohtë dhe sapun për të larguar çdo njollë.

Substancat që duhet të evitohen për pastrimin e mermerit janë ato acidike, lëngu i limonit, acidi citric, detergjente agresive dhe solucione të tjera gërryese, për shkak të delikatesës së mermerit. Duhet të shmangen edhe instrumentat dhe mjetet gërryese të cilat mund të çojnë në dëmtimin e mermerit në mënyrë të pakthyeshme. Nuk duhet të fërkohet asnjëherë biokarboni direkt në mermer, për mos ta gërvishtur. Ai duhet të lihet të veprojë (pasi të jetë përgatitur dhe tretur në ujë), dhe më pas të hiqet pa u fërkuar direkt për shkak të sipërfaqes delikate.

Çdo ditë duhet të bëhet pastrimi me makineri të sipërfaqeve të mermerit, duke zbatuar kushtet dhe kërkesat teknike të përshkruara më sipër.

Dyshemeja e kuarcit:

Për pastrimin e dyshemesë së kuarcit, së pari duhet të sigurohet që të bëhet pastrimi i menjëhershëm i njollave. Për pastrimin e tij duhet të përdoren produkte natyrore me përmbajtje biokarbonati, e cila mundëson përveç heqjes së njollave edhe heqjen e kalkares.

Pastrimi themelor duhet të bëhet të paktën 1 herë në muaj me produkte natyrore, të fërkohe sipërfaqja dhe të lahet me ujë të bollshëm. Produktet për larjen e tij nuk duhet të jenë agresivë, të përmbajnë klor ose amoniak dhe nuk duhet të aplikohet produkt i nxehtë mbi dyshemenë e kuarcit. Nuk duhet të ushtrohet forcë pasi kjo mund të çojë në çarjen e tij.

Dyshemeja e betonit:

Për pastrimin e dyshemesë së betonit duhet të përdoren produkte me pH neutral. Ajo është shumë poroze, pra thith shumë shpejt ndotjen. Njollat, si ato të vajit, eliminohen me vështirësi. Gjatë kalimit të kohës prodhon pluhur, nga ku mundësia për të vazhduar me një trajtim ndaj njollave dhe ndaj pluhurit vështirësohet. Probleme të veçanta vijnë nga varieteti i komponentëve të panjohur.

Dyshemeja e granitit:

Graniti ka një papërshkueshmëri dhe rezistencë ndaj njollave. Duke qenë se një nga tiparet e granitit është papërshkueshmëria, mund të përdoren detergjentë për pastrimin e tualetit, dhe zonave rreth pishinave. Nuk mund të aplikohet dyll mbi dyshemenë e granitit, për t’i dhënë shkëlqim sepse bëhet jashtëzakonisht i rrëshqitshëm kur kalohet mbi të. Nuk mund të aplikohet dylli natyral i metalizuar sepse nuk puthitet. E vetmja mbrojtje e mundur është plastika e metalizuar, ose me ato të metalizuara me rrjetëzim të lartë, por këshillohet përdorimi vetëm në rastet kur është domosdoshmërisht i nevojshëm. Mbi granitin nuk janë të aplikueshme teknikat e kristalizimit, veprimi i lëmit rezulton si më i ngadalshëm sesa mermeri për shkak të fortësisë më të madhe.

Të gjithë detergjentët për pastrimin e dyshemeve të mësipërme duhet të jenë një cilësie të lartë. Në rast të kundërt, ato nuk do të lejohen të përdoren dhe do të kthehen mbrapsht.

Kryerja e shërbimit DDD:

Për kryerjen e shërbimit DDD, do të jetë e nevojshme të merren masat e mëposhtme:

- Masa kundër mushkonjave – larvave.
- Masa kundër mizave që lidhen me ndotje fekale në afërsi.
- Masa kundër gjarpërinjve.
- Deratizimi.

Luftimi i insekteve fluturake:

Mushkonjat: Për shkak të nivelit të pusetave dhe të qëndrimit të ujit në to, është konstatuar zhvillimi i larvave, që duhen dominuar me larvicid Diflubenzuron (trajtime 2 – 3 javore), ose me Bti + Bsph që përdoren edhe në zonën bregdetare. Trajtimet duhet të fillojnë në fillim të Muajit Mars dhe deri në fund të muajit Tetor.

Mizat e fekaleve: Këto insekte janë shfaqur me intensitet të dukshëm prapa godinës, në afërsi të një vile jashtë territorit (murit), që nuk ka kanalizime të ujërave të zeza. Këto insekte kanë depërtuar edhe në brendësi të godinës së OST dhe duhet të trajtohen me insekticid me pompë. Eliminimi i vatrës ku zhvillohen është mjeti më i mirë, por duke qenë se kjo gjë është e pamundur, duhet të vazhdojë trajtimi mujor me insekticid të fuqishëm, për shkak të rezistencës që paraqesin.

Largimi i gjarpërinjve:

Infestimi nga gjarpërinjtë ndodh më shumë në pjesën e përparme (porta kryesore), për shkak të terrenit me ujë, si zonë me gjarpërinj. Megjithatë duhet mbajtur gjithë territori i gjelbëruar i objektit të OST. Për këtë do të përdoren:

- Repellentit për Reptile RR-2 është një mjet miqësor me njeriun dhe mjedisin për trajtimin e infektiveve me zvarranikë.

Zvarranikët janë shumë të ndjeshëm ndaj vibracioneve. Ata po ashtu i ndjejnë dridhjet e brendshme të tokës jashtëzakonisht mirë. RR-2 e kthen atë në avantazhin e vet. Prodhon një zhurmë vibruese çdo 30 sekonda. Emisionet e tingujve janë frikësuese ndaj zvarranikëve dhe më në fund i trembin ato. Pajisja është tërësisht e padëmshme për njerëzit dhe kafshët shtëpiake. Repellentit për Reptile RR-2 është efektive edhe kundër disa brejtësve të tokës si moles / Talpa Europea, L. / dhe mol-rats / Spalax Leucodon / s. Sipërfaqja efektive e pajisjes është rreth 800m² ose afërsisht një rreth me diametër 35m.

Duhet të kontrollohet rregullisht nëse pajisja funksionon, nëse ka tinguj të dukshëm ose dridhje. Për performancën optimale të pajisjes, duhet të vendoset në zonën që ndihmon për të prishur strehëzat e reptilëve.

Këto mjete do të jenë prezentë nga Muaji Mars deri në fund të muajit Tetor. Sipërfaqet që do të mbulohen, përfshirë zonën jashtë objektit, në hyrje, pranë burimit të ujit (përroit).

Monitorimi dhe dokumentacioni:

- Deratizim, monitorim të paktën 1 herë në muaj, zëvendësim produkti në rast konsumi.
- Luftimi i insekteve – mushkonjat. Trajtime çdo 2 – 3 javore me larvicid.
- Mizat e fekaleve, trajtime 3 javore.
- Largimi i gjarpërinjve, trajtime gjatë (Mars – Tetor).
- Të gjitha shërbimet më sipër do të kryhen më shpesh në raste të shfaqjes së problemeve apo kërkesave.

Kalendar i shërbimeve DDD:

Shërbimi	Janar	Shkurt	Mars	Prill	Maj	Qershor	Korrik	Gusht	Shtator	Tetor	Nëntor	Dhjetor	Përmbledhje
-----------------	-------	--------	------	-------	-----	---------	--------	-------	---------	-------	--------	---------	-------------

Deratizim	X	X	X	X	X	X	X	X	X	X	X	X	12 muaj
Dezinsektim			X	X	X	X	X	X	X	X			8 muaj
Largim gjarpërinjsh			X	X	X	X	X	X	X	X			8 muaj

Shërbimi i kopshtarisë:

Për mirëmbajtjen e ambienteve të gjelbra të OST, kopshtarët në dispozicion duhet të kenë të gjitha mjetet e punës të nevojshme për realizimin e shërbimit (makineri kositive bari, gërrshërë, krëhër, dorashka pune etj. Për kryerjen e shërbimit të kopshtarisë, Kontraktuesi duhet të ketë parasysh specifikimet e mëposhtme:

Vaditja:

Plotësimi i nevojave për vaditje gjatë periudhës së shirave është menduar të bëhet me ujin e mbledhur në puset e drenazhit. Për këtë arsye në dy puset e drenazhit nga ana lindore e godinës janë instaluar dy elektropompa. Këto elektropompa me anë të një rrjeti hidraulik të realizuar me tuba HDPE përdoren për mbushjen e dy depozitave të ujit me kapacitet rreth 20 m³ ujë secila. Funksionimi i tyre është automatik.

Gjatë sezonit të thatë sasia e ujit që gjendet në katër puset e ndërtuara do të përdoren për vaditjen e pemëve dhe të barit. Gjatë periudhës së thatë të verës, nga mungesa e shirave, puset nuk grumbullojnë sasinë e nevojshme për plotësimin e nevojave për vaditje. Nga eksperiencat e mëparshme sasia shtesë që kërkohet për vaditjen e barit, luleve dhe pemëve është 1200 m³ në total.

Normat e ujitjes:

Nr.	Emërtimi	Njësia e matjes	Norma për m ²
1-	Për ujitjen e sipërfaqeve të gjelbëruara	2 herë/ditë	1.5 litër
2-	Për ujitjen e sipërfaqeve të mbjella me lule	1 herë/ditë	1.5 litër
3-	Për larjen e ambienteve të jashtme dhe trotuareve në ditë me kohë të nxehtë	1 herë/ditë	2 litra
4-	Për pemët, ligustrat dhe shkurret	1 herë/ditë	5 litra

Vaditja e ambienteve të jashtme të godinës realizohet me anë të një sistemi automatik, i shpërndarë në të gjithë territorin e gjelbër, marka “ORBIT”. Ka tre panele komandimi me 22 degë dhe 235 sprucator. Panelet komandohen që të funksionojnë më vete, me një kohë hedhje rreth 15 minuta për çdo sektorë dhe dy herë në ditë, në mëngjes herët dhe pasdite.

Sprucatorët kanë nevojë për pastrim të herë pas hershme, pasi bllokohen nga barërat dhe baltërat që mund të bien mbi to. Operatori Ekonomik duhet ti mirëmbajë, kontrolloj, riparojë dhe në rast nevojë të bëjë dhe zëvendësimin e tyre.

Kositja e barit:

Kjo masë agroteknike stimulon tufëzimin e barit. Që nga pranvera deri në mesin e Qershorit bari kositet në lartësi 2.5-3 cm, kurse gjatë verës deri në 4 cm, në mënyrë që me sukses të ruhet lagështia në tokë dhe që rrënja të zhvillohet më mirë. Kositja e shpeshtë dhe e ulët zvogëlon masën e rrënjëve dhe të gjetheve të barit. Koha e kositjes caktohet sipas sipërfaqes së gjetthes. Gjatë kositjes asnjëherë nuk duhet të largohet më shumë se 1/3 të sipërfaqes së gjetthes. Kositja e barit duhet të bëhet dy herë në muaj gjatë stinës së verës, dhe të paktën dy herë në muaj gjatë stinës së dimrit.

Për plehërimin:

Ushqimet më të rëndësishme si azoti, fosfori dhe kaliumi mundësojnë rritje më të mirë të barit dhe rezistencë më të madhe në dëmtime mekanike dhe fizike (shkelja, thatësia afatgjatë, reshje të shumta). Humbja më e madhe e ushqimeve është në periudhën e rritjes më intensive të barit, në Maj dhe në Qershor. Për këtë arsye është e rëndësishme që ushqimi të shtohet në fillim të pranverës (Shkurt – Mars). Gjatë rritjes intensive të barit shtohen vetëm plehurat azotike (amoniak), të cilat veprojnë ngadalë, në mënyrë që mos të ndodhë rritja e shpejtë e barit. Gjatë stinës së verës, rritja e barit është me e ngadaltë dhe duhet plehëruar me pleh azotic (me nitrate). Kjo gjë duhet të bëhet 2 herë gjatë stinës së verës.

Për spërkatjen dimërore të pemëve preferohet përdorimi i vajrave industriale të kombinuara me preparate me bazë Bakrin (Cu). Për këtë kohë preferohet vaji i kuq i cili në vete përmban 100 gr në 1 litër Oksid të bakrit dhe 550 gr/litër vaj parafine të rafinuar. Ky preparat ka veprim: baktericid, insekticid dhe akaricid. Ky preparat nëse përdoret në fazën e qetësisë dimërore të pemëve-fundi i fazës A-sythy dimëror, dozimi duhet të jetë 2.5-3%. Nëse trajtimi bëhet më vonë, në fazën e majës së gjelbërt të sythave (fenofaza B dhe C) koncentrimi duhet të jetë 1-1,5%.

Pastrimi i trotuareve: Për pastrimin e ambienteve të jashtme dhe trotuareve Kontraktuesi duhet të vejë në dispozicion një punonjës të posaçëm. Ai duhet të bëjë fshirjen e ambienteve të jashtme, si dhe pastrimin e trotuareve me makineri pastrimi trotuaresh.

Pastrimi i gropave septike: Për dimensionimin e rrjetit të ujërave të zeza është përdorur program i llogaritjeve 4M/CALC.

Largimi i ujërave të zeza është me gravitet për katet e nivelit zero dhe +1 ndërsa për katin nën toke largimi i ujërave të zeza kryhet me pompe.

Në katet 0 dhe +1 shkarkimet ecin në mënyrë horizontale me pas vertikalisht ato arrijnë deri tek tavanin e katit -1, dhe përsëri me rrjet horizontal ato lidhen me rrjetin e jashtëm të shkarkimeve në pjesën e pasme të godinës.

Për shkak të pengesave konstruktive që hasen në grupin e banjave të kuzhinës në nivelin zero çdo grup do të zbrësë individualisht në nivelin -1. Në tavanin e -1 këto zbritje bashkohen ndërmjet tyre dhe pastaj do të bashkohen me pjesën tjetër të rrjetit për të vazhduar rrugën drejt rrjetit të jashtëm. Pjerrësia e tubave horizontal është $j = 1.5\%$. Në çdo ndryshim drejtimi të këtij rrjeti janë instaluar tapa pastrimi.

Në katin -1 në korridorin teknik dhe mbrapa grupeve të banjave të çdo seksioni është instaluar nga një depozite për ujërat e zeza të këtyre grupeve. Çdo depozite është e pajisur me çifte pompash elektrike.

Të gjitha ujërat e zeza grumbullohen në anën perëndimorë të godinës në dy gropa septike me kapacitet 20 m³ secila. Receptioni të hyrja e objektit funksionon me gropë septike më vetë me kapacitet 5 m³ në total.

Pastrimi i mbetjeve të ujërave të zeza bëhet në mënyrë periodike (një herë në muaj) me qëllimin për mos kalcifikimin e mbetjeve. Ngurtësimi i tyre krijon pamundësi të heqjes dhe për një periudhë kohe mund të ngrihet dhe niveli i gropave septike.

Mbrojtja dimërore e pemëve:

Periudha e qetësisë relative të pemëve, duhet shfrytëzuar për krasitjen, mbrojtjen e pemëve kundër sëmundjeve dhe dëmtuesve. Mbrojtja përmbahet në masa mekanike dhe kimike.

Ndër masat mekanike duhet përmendur: pastrimi i pemëve nga strofullat e dëmtuesve të ndryshëm, heqja e degëzave të lënduara dhe të infektuara, mbledhja e frutave të kalbur që mund të kenë mbetur ende në pemë, mbledhja e gjetheve dhe mbeturinave të tjera që kanë rënë nën pemë dhe ndezja e tyre. Në këtë mënyrë, largojmë burimet e infeksionit, prej nga herët në pranverë dalin sporet dhe hifet e këpurdhave të ndryshme si dhe vezët dhe insektet e rritur të cilat shkaktojnë infeksionet primare dhe i sulmojnë pemët që në fazat e para të fillimit të vegjetacionit.

Masat kimike të mbrojtjes dimërore kanë të bëjë me: spërkatjen e pemëve me preparate kimike kundër shkaktarëve të sëmundjeve dhe dëmtuesve. Shumë dëmtues dhe shkaktarë të sëmundjeve dimërojnë në kurorën e pemëve ose nën të në tokë dhe mbeturina bimore. Me spërkatjen dimërore shkatërrohen format dimërore të tyre. Spërkatja dimërore duhet të bëhet gjatë kohës së qetë, të thatë dhe të nxehtë, kuptohet gjatë kohës së qetësisë relative – nga koha e rënies së gjetheve deri para fillimit të vegjetacionit. Preferohen dy spërkatje. Njëra në vjeshtë, me lëng bordolez ose me ndonjë preparat tjetër në bazë të bakrit, kurse tjetra pak para fillimit të vegjetacionit, mundësisht pas përfundimit të krasitjes dimërore, që të shmangen infeksionet e mundshme nga plagët e shkaktuara gjatë krasitjes, preferohen vajrat mineral si: Vaji i kuq, preparati Oviphyt etj.

Dëmtuesit të cilët mund të luftohen përmes spërkatjes dimërore janë të shumtë. Po përmendim disa prej tyre: morrat e ndryshëm të gjetheve, marimanga e kuqe, morri i përgjakur, larvat gjethepërdredhësit, lulengransat etj.

Nga sëmundjet që mund të luftohen me spërkatjen dimërore mund të përmendim: kromën dhe hirin, të cilat me sukses mund të luftohen me preparate në bazë të bakurit si: qorba bordoleze, preparati Champion, Cuprablau Z etj. kundër hirit mjaft efikas janë edhe preparatet në bazë të sulfurit: Chromosul, Sumpor SC-80 etj.

Pemët dhe lulet që ndodhen në Ambientet e Brendshme dhe të Jashtme te OST sh.a.

Nr	Emërtimi	Njësia	Sasia	Lloji i shërbimit
1	Ligustra të shkurtra	copë	60	shërbim & mirëmbajtje
2	Ligustra të gjata	copë	770	shërbim & mirëmbajtje
3	Zvarranikë të shkurtër	copë	580	shërbim & mirëmbajtje
4	Zvarranikë të gjatë	copë	30	shërbim & mirëmbajtje
5	Rozmarina jeshile	copë	520	shërbim & mirëmbajtje
6	Rozmarina Gri	copë	280	shërbim & mirëmbajtje
7	Dafina	copë	220	shërbim & mirëmbajtje
8	Shkurre	copë	20	shërbim & mirëmbajtje
9	Lule të ndryshme për ambient të brendshme në ishuj.	copë	90	shërbim & mirëmbajtje
10	Lule për ambient të brendshme me vazo të mëdha.	copë	53	shërbim & mirëmbajtje
11	Lule për ambient të jashtëm me vazo të mëdha.	copë	11	shërbim & mirëmbajtje
12	Peme të ndryshme (ullinj, blirë, molle, dardhe, carac, limona, etj.)	copë	205	shërbim & mirëmbajtje
13	Lule për ambient të jashtëm (mëllaga, ciklamin, etj.)	copë	1,400	shërbim & mirëmbajtje, dhe zëvendësim sezonal

* *Lulet sezonale për ambientin e jashtëm, gjatë gjithë perimetrit të jashtëm të godinës si mëllaga, ciklamin etj. do të zëvendësohen me kërkesë të Autoritetit Kontraktor, në kohën e përshtatshme sipas stinëve (dimër - verë). Sasia në totalë e luleve që do të zëvendësohen për të dyja stinët do të jetë 1,400 copë.*

* *Sasia e nevojshme e ujit për vaditje, në total është 1200 m³, gjatë gjithë shtrirjes së kontratës. Depot e ujit do mbushen sipas nevojës në sezonin e verës me kërkesë dhe në bashkëpunim me Autoritetin Kontraktor.*

Për kryerjen e këtyre shërbimeve nevojiten makineritë si më poshtë vijon:

Makina fshirëse e trotuareve:

Për kryerjen e shërbimit të pastrimit të trotuareve të jashtme rrethuese të godinës së AK, Operatori Ekonomik duhet të disponojë një makineri të posaçme për fshirjen e trotuareve, e cila duhet të përdoret nga një punonjës i posaçëm.

Gjerësia e makinës duhet të jetë jo më pak se 1,300 mm me një performancë maksimale pastrimi deri në 8,800 m²/orë. Gjatësia e furçës kryesore të jetë jo më pak se 700 mm, me një bateri prej rreth 48 Volt.

Ajo duhet të jete karikuar përpara se të fillojë orari i punës çdo ditë dhe bateria të rezistojë të paktën 6 – 8 orë. Kapaciteti i saj duhet të jetë të paktën 120 litra, për të ndihmuar në këtë mënyrë punonjës in e shërbimit duke i mundësuar atij që derdhjen e mbeturinave ta bëjë çdo fund dite dhe jo disa herë gjatë ditës. Fuqia motorike e saj duhet të jetë të paktën 1200 W dhe fuqia e punës

(motori) i fuqës kryesore + fuqës anësore + vibracioni i pluhurit duhet të jetë të paktën 700+2*100+50 W. Shpejtësia maksimale gjatë punës duhet të jetë deri në 6 km/h.

Makina larëse e dyshemesë – lavasciuga:

Makina larëse e dyshemesë është një element shumë i rëndësishëm i mirë organizimit dhe mbarëvajtjes së pastrimit të ambienteve të brendshme. Ajo duhet të jetë e një cilësie shumë të mirë, për të shmangur çdo dëmtim apo gërvishtje të dyshemesë me përbërje të ndryshme (mermer, granit, kuarc) pasi janë shumë delikatë.

Makineria duhet të ketë një kapacitet për larjen e rreth 1,600 m²/orë, me një gjerësi pune prej 51 cm, me 1 fuqë/disk i cili të zëvendësohet periodikisht. Serbatori i makinerisë, në të cilin do të hidhet uji dhe detergjenti, duhet të jetë me një kapacitet prej të paktën 40 litrash. Duke qenë se do të punohet në ambientet e brendshme, niveli i zhurmës së makinerisë duhet të jetë në nivelet dB <65.

Punonjësi i cili do të kryejë shërbimin e larjes së dyshemeve me makineri lavasciuga duhet ta përdorë shumë mirë makinerinë.

Makina kositëse e barit:

Makina kositëse e barit, e cila do të përdoret për kositjen e barit në ambientet e gjelbra të OST, duhet të jetë e sigurt gjatë përdorimit dhe të ketë një nivel të ulët të zhurmës (76 dB (A) në mënyrë që mos të shqetësojë punonjësit e OST që janë duke punuar në godinë.

Gjerësia e prerjes së saj duhet të jetë të paktën 46 cm dhe lartësi e prerjes 19-73 mm. Kapaciteti i qeses së grumbullimit të mbetjeve duhet të jetë afërsisht 65 litra dhe duhet të punojë për një kohë deri në 12.5 orë në ditë dhe të ketë një fuqi motori deri në 1200 Volt.

Autokullë vinç:

Autokullë vinç në lartësi mbi 30 metra për larjen e fasadës së jashtme të godinës së OST. Krahu i hapjes së vinçit të jetë 22 metra dhe rrotullimi i platformës të jete 360° të vazhdueshme. Koshi duhet të jetë i montuar në krahun e vinçit (i pa çmontueshëm).

Godina e OST sh.a është ndërtesë dy katëshe dhe përgjatë gjithë perimetrit është e rrethuar nga lulishte dhe kalim për në bodrumin e Godinës. Distanca nga vendi ku mund të montohet vinçi deri në sipërfaqen e godinës varion nga 6.2 metra në pjesën mbrapa, 19.4 metra në pjesën anësore dhe 19.8 metra në pjesën ballore. Lartësia e godinës varion nga 9.2 metra deri në 9.7 metra në pjesën ballore.

Referuar përlllogaritjeve të mësipërme për të kryer shërbimin e mirëmbajtjes dhe pastrimit të përditshme të ambienteve të brendshme, të jashtme dhe të gjelbërta të godinës së OST, krahu i hapjes së vinçit duhet të jetë mbi 22 metra.

Platformë ajrore / ngritëse:

Platforme ajrore / ngritëse për përdorim në ambientet e brendshme për punimet dhe ngritje në lartësi. Platforma duhet të jetë me lartësi mbi 8 m. Platforma nuk duhet të jetë me lëndë djegëse pasi do punoj në ambiente të brendshme dhe me përmasa jo me shumë se 240 e lart dhe 160 e gjerë.

Makineritë profesionale për ofrimin e shërbimit të pastrimit:

Makineri thithëse pluhurash dhe lëngjesh - 6 (gjashtë) copë ose më shumë.

Makineri larje-tharje – 1 (një) copë ose më shumë.

Makinë teknologjike për heqjen e mbeturinave.

Makinë autobot për heqjen e ujërave të zeza.

Pompë motorike të montueshme në automjet për kryerjen e DDD-ve.

Makinë autobot për furnizimin me ujë, për vaditje, me kapacitet jo më të vogël se 5 m².

Mjete transporti për njerëzit dhe mallrat, -të paktën dy automjete.

Shtojca 13

[Shtojcë për t’u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor]

NJOFTIM STANDARD PËR OFERTUESIN E SKUALIFIKUAR³

[Vendi dhe data]

[Emri dhe adresa e autoritetit kontraktor]

[Adresa e ofertuesit]

I/E Nderuar, Z/Zj. <emri i kontaktit>

Ju falenderoj për pjesëmarrjen në procedurën e lartpërmendur të prokurimit publik. Procedura e kryer në përputhje me Ligjin nr. 9643 datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik” .

Oferta juaj u vlerësua me kujdes sipas kushteve dhe kërkesave të përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e ofertës. Me keqardhje ju informoj se u s’kualifikuat, sepse oferta e dorëzuar nga ju u refuzua për shkak të arsyes (-ve) së/të mëposhtme :

Nëse mendoni se Autoriteti Kontraktor ka shkelur LPP ose RrPP gjatë procedurës së prokurimit publik, atëherë keni të drejtë të filloni një procedurë rishikimi sic parashikohet në Kreun VII të LPP.

Edhe pse nuk mundëm të përdornim shërbimet tuaja në këtë rast, besoj se do të vazhdoni të jeni i interesuar në nismat tona të prokurimit.

Me respekt
< Emri >

³ Ky njoftim duhet të përdoret në rastin e procedurave të prokurimit që zhvillohen në rrugë shkresore

Shtojca 14

[Shtojcë për t’u plotësuar Autoriteti Kontraktor]

FORMULARI I NJOFTIMIT TË FITUESIT

[Data_____]

Për: [Emri dhe adresa e ofertuesit të shpallur fitues]

Procedura e prokurimit:

Numri i referencës së procedurës/lotit:

Përshkrim i shkurtër i kontratës: [Sasia ose qëllimi dhe kohëzgjatja e kontratës]

Publikime të mëparshme (nëse zbatohet): Buletini i Njoftimeve Publike [Data] [Numri]

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit: çmimi më i ulët oferta ekonomikisht më e favorshme

Njoftojme se, kane qenë pjesëmarrës në procedurë këta ofertues me vlerat përkatëse të ofruara:

1. _____

Emri i plotë i shoqërisë

numri i NIPT-it

Vlera _____

(me numra dhe fjalë)

2. _____

Emri i plotë i shoqërisë

numri i NIPT-it

Vlera _____

(me numra dhe fjalë)

Etj. _____

Janë skualifikuar ofertuesit e mëposhtëm:

1. _____

Emri i plotë i shoqërisë

numri i NIPT-it

2. _____

Emri i plotë i shoqërisë

numri i NIPT-it

Përkatësisht për arsyet e mëposhtme:

* * *

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë [emri dhe adresa e ofertuesit të shpallur fitues] se oferta e paraqitur, me një vlerë të përgjithshme prej [shuma përkatëse e shprehur në fjalë dhe shifra]/pikët totale të marra [_____]është identifikuar si oferta e suksesshme.

